



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 136 datë 26-12- 2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 18 DHJETOR 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 18.12.2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës **18 dhjetor 2025** bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-12-2025

K R Y E T A R E

Ana VERUSHI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 18 DHJETOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Nënkyetari i Bashkisë Kletjon Kita dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Për shkak të disa problemeve teknike të transmetimit online të mbledhjes, nuk ka audio në tre pikat e para të rendit të ditës.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS DATËS 27 NËNTOR 2025”.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1- 30 NËNTOR 2025”.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 30 këshilltarë, 30 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE VLERËS TË QIRASË NË TREGUN E LIRË”.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Gazonierja ka qënë me një mbështetje prej 7 mijë lekë bëhet 8 mijë e 350. Apartamenti 1+1 ka qënë 12 mijë lekë në muaj bëhet 13 mijë e 500, apartamenti 2+1 ishte 15 mijë bëhet 15 mijë e 600, apartamenti 3+1 mbetet në kuotën që ka qënë 20 mijë, pra në këtë material evidentohet saktë rritja e mbështetjes që jep Bashkia Korçë për zbatimin e këtij programi dhe që vjen kryesisht për familjet me të ardhura shumë të ulta ose pa të ardhura fare. Këto familje kanë aplikuar tek sistemi online i strehimit, kanë ngarkuar dokumentat e duhur, është bërë vlerësimi kjo i takon materialit tjetër. Nëse keni pyetje mbi llogaritjen e qirasë mesatare, pse është kjo vlerë.

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga ekzekutivi nëse është marrë parasysh inflacioni apo rritja e çmimeve në përlllogaritjen e këtyre vlerave?

Këshilltare M.Qeleshi: Doja të dija në këtë material nuk është vënë kostoja totale e subvencionit, diferenca midis qirasë të tregut dhe qirasë të përballushme, vihet këtu apo tek buxheti që do jetë javës tjetër?

Këto nuk kishte një vlerë totale të subvencionimit për qiratë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar K.Pllaha: Shoh që ka rritje, kjo rritje është e përvitshme dhe në % kjo rritje është në masën e të paktën inflacionit siç tha dhe z.Petri për kategorinë e veçantë?

Shoh që qiraja mesatare e subvencionuar, është marrë nëpërmjet 10 ofertave, është mundësia që të kemi një database nga tatimet apo dikush tjetër që të shohë gjithë qiratë në qytetin e Korçës apo që të bëjë një mesatare të tyre, jo nëpërmjet ofertave por nëpërmjet qirave normale.

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Unë e saktësova dhe thashë në ligjin për strehimin social, qiraja mesatare është përcaktuar qartë sesi bëhet llogaritja dhe është në kuptim të pikës 36 të

nenit 2 ku thuhet bëhet standartizimi i ofertave të qirave ku patjetër përfshihet dhe inflacionit, por që të bëhet indeksim nëpërmjet koeficientit të inflacionit jo. Kostoja mesatare e këtij ndryshimit të nivelit maksimal të subvencionimit nuk vjen tek ky material por tek një material tjetër ku ne e kemi saktësuar komplet fondin e nevojshëm që duhet për të mbështetur familjet që vijnë nga subvencioni. Unë e kam përlogaritur në % rritjen e qirasë dhe për tipologji të ndryshme kemi rritje të ndryshme, tek gazonierja kemi 17 % e tejkalon normën e inflacionit, kemi apartamentin 1+1 që shkon në 13.4 % edhe ky e tejkalon edhe apartamenti 2+1 ka një rritje në masën 4 %. Llogaritja e këtyre qirave mesatare në vetvete vjen edhe si ndryshim për shkak të normës të inflacionit por i referohet tregut dhe kontratave efektive që janë bërë në treg të lirë. Këto oferta janë të dokumentuara në kontrata qiraje të bëra në tregun e lirë para noterit si pronar social sepse qiraja në treg kap edhe vlera të pa përballueshme për shumë familje por ne po flasim për atë kategori që është në nevojë emergjente për strehim dhe nëse në familje ka në përbërje familjare 3 persona ne i referohemi vendimit që ka të përcaktuar ligji dhe jemi të detyruar që këtë familje ta mbështesim për tipologjinë 1+1 ku kemi të përcaktuar edhe qiranë mesatare.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka diskutime nga këshilltarët, nëse jo hapim procesin e votimit?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 32 këshilltarë, 32 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Sipas aplikimeve të bëra në sistemin online në drejtorinë e strehimit, nga vlerësimi i aplikimeve kanë arritur të plotësojnë kushtet dhe dokumentacionin 25 familje të cilat do marrin mbështetje nga bashkëfinancimi me buxhetin e shtetit 50 me 50 . Ky subvencionim do fillojë menjëherë data kur lista e përfituesve të miratohet në Këshillin Bashkiak , ne kërkojmë miratimin e Këshillit për këtë material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje ?

Këshilltare M.Qeleshi: Referuar të ardhurat për frymë për vitin 2024. Tani është lapsus apo deri këtu ka nxjerrë instati të dhënat të ardhurat për frymë nga anketa e nivelit të jetesës?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ka pyetje tjetër?

Drejtorja e Strehimit Social M.Balli: Jo nuk është lapsus, janë përlogaritur për vitin 2024. Në vitin 2025 duhet të vijnë të aplikojnë për vitin 2026, deri këtu kemi informacionin nga Instati

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje, nëse jo hapim procesin e votimit?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 32

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 32 këshilltarë, 32 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse për Arsimin ka dërguar për miratim bursat për nxënësit e shkollave të mesme profesionale publike, bashkëngjitur ka dërguar dhe numri i nxënësve që do përfitojë bursë sipas kriterëve. Numri i nxënësve që do përfitojë bursë të plotë janë 461 nxënës, 21 nxënës përfitojnë 58 % bursë, 98 nxënës do përfitojnë bursë sipas kriterit ekonomik, 175 nxënës do përfitojnë sipas kriterit jo ekonomik, 2 nxënës për rezultate të arritura, 207 nxënës sipas kriterit të degëve parësore, 103 nxënës do përfitojnë veshmbathje dhe 17 nxënës kuotë ushqimore. Komisioni i mbledhur ditën e enë vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje, nëse jo hapim procesin e votimit?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 31 këshilltarë, 31 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “ QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Qendra Sportive Korçë ka dërguar për miratim buxhetin e vitit 2026, shuma vjetore do jetë 97 milion e 504 mijë e 757 lekë, nga të cilat kontributi i Bashkisë do jetë 91 milion e 804 mijë e 757 lekë dhe 5 milion e 700 mijë do jenë nga të ardhurat e veta. Qendra Sportive ka detajuar edhe shpenzimet që do jenë për vitin 2026 të cilat kontributi i Bashkisë për ekipin e futbollit do jenë në një vlerë 38 milion 666 mijë e 400 lekë, të cilën janë parashikuar shpenzimet për trajtimin ushqimor të ekipit të parë të futbollit Skënderbeu si edhe dietat edhe udhëtimet zinxhir për ekipin e futbollit. Në total janë 138 sportistë që përfitojnë nga ky fond. Gjithashtu kjo qendër ka parashikuar një fond prej 18 milion e 571 mijë e 140 lekë për pagat dhe 3 milion e 101 mijë e 380 lekë për kontributin e sigurimeve shoqërore, kjo është për 29 persona punojës të kësaj qendre. Gjithashtu janë edhe shpenzimet operative që kapin një vlerë 32 milion e 673 milion lekë, ky fond përfshin ngrohjen e ambienteve, shpenzimet elektrike dhe shpenzime të tjera mirëmbajtje, Gjithashtu kanë një fond prej 4 milion e 170 mijë lekë për vitin 2026 për investime të ndryshme të cilat do ju duhen për amortizimin e ambienteve dhe terrenve, Komisioni vendosi t'ja kalojë Këshillit për miratim. Gjithashtu meqënëse Korça mori titullin Qyteti European i Sportit urojmë të jetë një vit i mbushur me aktivitete sportive që do i shërbejnë komunitetit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Z.Bregu i pari, megjithëse do e nisja nga zonjat.

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh bilancin e paraqitur nga shoqëria aksionere vëmë re që në fillim, pagat, shpërblimet shkojnë në vlerën rreth 220 mijë euro në vit. Që këtu lind pyetja, a ja vlen që kjo shoqëri aksionere të funksionojë në këtë format?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje drejtuesi i shoqërisë duhet të na paraqesë një tabelë se cilat janë aktivitetet që kryen kjo, cilat janë përfitimet e komunitetit që Bashkia të kryejë gjithë këtë investim sepse kemi parasysh se kjo shoqëri sjell vetëm 5 milion e 700 mijë lekë të ardhura rreth 57 mijë euro të ardhurat, ndërkohë që shpenzimet total shkojnë gati 1 milion euro sepse ndoshta do duhet që kjo shoqëri të ndryshojë formatin dhe të kalojë në formë tjetër riorganizimi. Nuk e kam fjalën jo organizimi si sh.a apo shpk organizimi si strukturë funksionale për detyrat që kryejnë apo qëllimet. Besoj e kuptuat pyetjen nëse ka paqartësi më pyesni. E dyta nëpërmjet kësaj qendre kalon në formë kontributi nga Bashkia Korçë shuma prej rreth 400 mijë euro në vit, kontributi i Bashkisë për ekipet e futbollit dhe kryesisht për ekipet e futbollit pjesa më e madhe shkon për ekipin e Skënderbeut e cila është shoqëri tjetër aksionere, prej dy vitesh i kemi kërkuar ekzekutivit që të na informojë nëse është aksionere apo jo dhe ekzekutivi na është përgjigjur se nuk e dinte. Më pas ka kuptuar nga dokumentacioni i nxjerrë nga QKB- ja nga një këshilltar që qenka aksionere Bashkia tek kjo shoqëri dhe Bashkia nuk e dinte.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Më fal që po ndërhy por ju lutem bëni pyetjet si fillim pastaj diskutimet, të ndani pyetjen.

Këshilltar E.Bregu: Në sqarim të ndërhyrjes tënde po bëj shtrimin që po i bëj situatës është pyetja të kuptohet nga personat që do japin përgjigje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mos aludoni që nuk kuptojnë, bëni pyetje.

Këshilltar E.Bregu: Pa shpjeguar situatën nuk e dinë si ta shpjegojnë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: E kuptojnë sepse e keni shtruar disa herë.

Këshilltar E.Bregu: Nuk dua të paragjykoj asnjë por dua ta kuptojnë sa më qartë. Kryetari i Bashkisë na tha se i është drejtuar me shkresë aksionerit mazhoritar të këtij ekipi për informacion edhe ende nuk na ka dhënë përgjigje, kjo është një prononcim i kryetarit të Bashkisë para 7-8 muajsh. Dua të di a ka erdhur ky informacion?

Kjo shumë që kalon për ekipin e futbollit Skënderbeu meqënëse Bashkia është aksionere tek ky ekip duhet mos shkojë në formë dhurate nëpërmjet Qendrës Sportive por të shkojë në formë kontributi, investimi brenda shoqërisë aksionere dhe jo brenda kësaj shoqërie.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ky është sygjërimi juaj që mund ta bëni kur të diskutoni, ju lutem bëjeni pyetjen.

Këshilltar E.Bregu: Pyetjen nuk e kuptove?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ta kuptova po mos vazhdoni bëni komente mbi pyetjen që bëni ju vetë mos zgjatemi sepse t'ju japim kohë edhe këshilltarëve të tjerë për pyetje.

Këshilltar E.Bregu: Pyetjen a e kuptove?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Unë e kuptova pyetjen edhe ata që ti i drejtoheshe e kuptuan. Z.Petri ka kërkuar fjalën.

Këshilltar L.Petri: Pyetjet e mia kanë të bëjnë me një analizë krahasuese që e gjej të munguar tek ky raport. A është e mundur që ekzekutivi të na thotë nga vjet tek ky vit si jemi, sepse na janë përmendur pagat për trajtim ushqimor, është e njëjta nga vjet me si vjet?

Është thënë mbulimi i pagave të organikës 29 persona, këta janë 100 % në punë dhe janë 100 % efektive, janë më shumë apo më pak nga vjet?

Është përmendur këtu energjia elektrike, kemi diskutuar dhe në mbledhjet e mëparshme kur ka qënë temë e rendit të ditës dhe është sygjëruar nga ne këshilltarët investimi me panele fotovoltaike jo për të zeruar por për të reduktuar zërin që është relativisht i madh për ngrohjen, a është planifikuar gjë për vitin 2026 dhe nëse po në çfarë shifrash dhe si është parashikimi që do arkëtoni të ardhurave që mund t'i bëni investimi tek tjetër sektor?

Pyetja tjetër ka të bëjë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, cila është marrëdhënia që ju keni me Fondin sepse kemi dëgjuar projektin që do bëhet tek Pallati i Sportit dhe sa do ndikojë kjo dhe si e keni ju këtë projeksion për vitin që vjen, pra çfarë rektori revultativ do sjellë kjo gjë?

Këshilltare A.Zheku: Një pyetje ma ezauroi kolegu parafolës, a keni bërë një plan për eficiencën e energjisë, reduktimin e kostove?

Pyetja tjetër ka të bëjë me investimet që kapin vlerën 4.17 milion, a ka një projekt të detajuar për secilin investim?

Buxheti në total them në % përfshin një kontribut nga Bashkia 94 % dhe të ardhurat e veta vetëm 6 %, përsa i përket impaktit publik sa qytetar përfitojnë nga këto shërbime dhe a kemi një matje të rezultateve sportive dhe sociale, pra statistika?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Do doja që këshilltarët të jenë pak të kujdesshëm sepse ne kur flasim për shifra, nuk flaim me euro, flasim me lekë dhe të jeni pak të kujdesshëm. Unë nuk zura emra por thashë të jemi të kujdesshëm. Pyetje tjetër?

Këshilltar D.Osmari: Disa nga pyetjet i ezauruan kolegër por kam diçka në lidhje me pyetjen që bëri Lazjoni, duke qënë se ky është viti i dytë rradhazi që e kërkojmë pjesën e një studimi dhe planifikimi të kostove të energjisë elektrike apo pjesërisht edhe kosotja e karburantit që shërben për ngrohjen nëase sepse të dy këto zëra janë goxha me peshë 16 milion lekë të dyja. Mesa shikoj unë tek planifikimi i këtij buxheti nuk është marrë parasysh kjo sepse nuk shikoj diçka të tillë për ndonjë studim dhe është fatkeqësi sepse duke qënë se jemi duke shkuar drejt energjisë të gjelbër e cila na takon edhe ne si qytet të jemi avangart sepse ka dhe probleme të tjera me ngrohjen me oxhaqe që tymi të gjithëve na dëmton, unë shoh se kjo duhet të ishte emergjenca e parë dhe një nga pikat kryesore të këtij buxheti, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit për sygjerimet sepse po bëjmë sygjerime dhe nuk po ndërtojmë pyetjet. Fjala për z.Fejzulla.

Këshilltar E.Fejzulla: Kisha një pyetje në lidhje me të ardhurat e vitit aktual që ne jemi, sepse thuhet që parashikohen të ardhura prej 5 milion e 700 mijë lekë për vitin 2026 sa janë të ardhurat e realizuara dhe a ka mundësi për të relaizuar më shumë apo kjo është kapaciteti maksimal që kjo qëndër mund të realizojë?

Dihet që kjo qëndër nuk është ngritur për të dalë me fitim sepse normalisht ka qëllime të tjera por pa diskutim që duhet të mundohemi të kapim vlerën maksimale të të ardhurave dhe të ketë një efijencë maksimale sa i përket kësaj gjëje, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka pyetje të tjera fjala për ekzkeutivin dhe më pas për shoqërinë për të dhënë përgjigje.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit për pyetjet, në fakt disa pyetje kërkojnë dhe përgjigje dhe me të drejtë janë ngritur. Unë po e nis nga fundi për efijencën ekonomike, ne kemi bërë një studim jashtë pjesës të operimit si institucion por ka një kosto relativisht të lartë që ne duhet ta studjojmë e ta shohim por fundi duhet të jetë rezultativ për shkak të ngarkesës financiare që ka pagesa e energjisë pasi është një qëndër e madhe atje dhe kërkon ngrohje dhe shpenzime energjie dhe nuk përfshin vetëm pjesën e qytezës brenda por edhe ambienteve jashtë. Nëqoftëse ja vlen të funksionojë qëndra nëse e kam kuptuar drejt apo mënyra si funksionon shoqëria, unë mendoj që Qyeta e Fëmijëve është një histori suksesi jo vetëm për qytetin e Korçës por gjithë Shqipërinë, jemi e vetmja qëndër që ofrojmë një shumëllojshmëri kursesh për moshën nga 0-14 vjet dhe për cdo lloj moshe për ambientet që vendosen në dizpozicion dhe bëjnë pagesën. Tani unë do i kërkoj administratorëve që t'ju venë një informacion të detajuar se çfarë ka ndodhur në vitin 2024 dhe 2025, sa aktivitete janë zhvilluar, sa fëmijë apo të rinj kanë marrë pjesë. Një informacion të shkurtër po ja u jap por të detajuar do i them administratorëve sepse është vërtet histori suksesi. Janë rreth 380 fëmijë të rregjistruar në kurse, rreth 600 fëmijë marrin pjesë në programet e përditshme, 420 fëmijë shfrytëzojnë terrenet sportive të rregjistruar nga akademia e futbollit, 120 fëmijë shfrytëzojnë terrenet e tenisit, gjithashtu shkolla 9-vjeçare shfrytëzojnë këto terrene për të bërë orët e mësimi, gjithashtu universitetet ka një marrëveshje me Qytezën për të zhvilluar orët e mësimi që kanë në universitet, është një gamë shumë e madhe aktorësh, edhe këto kampionatet e

futbollit, volejbollit zhvillohen tek Qyteza mendoj që është një nga institucionet apo SHA më rezultative në llojin e aktiviteteve që përfshin. Përsa i takon klubit të futbollit vetë e bëtë pyetjen vetë e dhatë dhe përgjigjen, nuk e kemi marrë akoma përgjigjen e kemi sqaruar çdo vit, ne si kontributin që japim si Bashki janë të ndara në dy zëra siç shpejgohet edhe në material. Një shkon për dietat për lëvizjet që bëjnë ato, aktivitetet sportive jashtë Korçe dhe tjetra kontributi në vlerën e trajtimit ushqimor në vlerën 57 mijë e 50 lekë për 30 sportistë që vijnë të federuar çdo vit dhe këto kalojnë pagresa individuale në llogaritë e gjithësecilit sipas kontratës që kanë bërë me klubin. Pyetjet e tjera administratorët i kanë mbajtur shënim, t'i diskutojnë ne detaje.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për z.Qirinxhi.

Ekzekutivi L.Qirinxhi: Unë do përpiqem t'i jap përgjigje disa nga pyetjeve, në rradhë të parë do bëj një panoramë të shkurtër të shpenzimeve, të ardhurave që kjo qëndër ka sepse vura re se këto ishin shumica e pyetjeve. E vërteta është se qendra është shumë e madhe dhe ka shumë shpenzime ngrohja, pagat, shpenzimet operative zenë pjesën më të madhe të buxhetit të qendrës. Këto shpenzime nuk i vendosim ne të jenë kaq më pak, apo më shumë ne i sjellim nga ekperienca e mëparshme duke ditur sesa është amortizimi, kostoja engrohjes që janë zëra bazike për mirë funksionimin e qendrës. Pjesa tjetër janë edhe materialet që nevojitet për materialet e kurseve, aktiviteteve. Të ardhurat e qendrës të vitit 2025 deri në momentin që flasim janë 5 milion e 500 mijë dhe ne pretendojmë se ne vitin pasardhës të gjenerojmë diçka më tepër. Ne e kemi filluar vitet e para diku te 4 milion lekë të reja, kemi shkuar 5 dhe vërtiten rreth këtyre shifrave sepse të ardhurat e qendrës janë nga kurset që ne zhvillojmë dhe nga lëshimi me qira i gjitha terreneve, ambienteve që disponon. Tarifat që ne operojmë janë të përcaktuara me vendim Këshilli Bashkiak dhe realisht janë shumë minimale për mos rënduar asnjë prind dhe sikur ne të 5-fishonim tarifat nuk do ishim rentabël sepse shpenzimet operative të qendrës janë shumë të mëdha, ka hapësirë të madhe, ka shumë punojës. Në lidhje me ndryshimin e structures që ka SH>A nuk jemi ne ata që vendosim, mund ta shikoni ju dhe ta diskutoni si të jetë e arsyeshme, përsa i përket kontributeve të futbollit dhe kjo është një pyetje që nuk më takon mua, as t'i jap zgjidhje dhe as t'i përgjigjem. Në lidhje me pagat dhe numri i punojësve, numri ka qënë 26 deri në vitin 2024, u shtua me 3 punojës këtë vit meqënëse u vendos se qendra rinore të jetë pjesë e organikës sportive, ne shtuam punojësit 1 është aktualisht në punë, po zhvillohet edhe një konkurs për të marrë një person tjetër në punë. Në lidhje me energjinë elektrike që në vitin e parë që n akeni bërë kërkesë për të pasur informacion nëse do instalonim panele diellore për të mbuluar energjinë elektrike edhe ngrohjen, në mbledhjen e rradhës të buxhetit kur kemi erdhur, unë personalisht kontaktova me një kompani në lidhje me koston dhe kostoja shkonte diku rreth 300 mijë euro për të mbuluar vetëm shpenzimet e energjisë elektrike të qendrës, nëse do mbulonte edhe ngrohjen do dyfishohej vlера. Nëse ne emndojmë t'i shmangim këto shpenzimeve do duhet të bëjmë një investim dikur rreth 600 milion lekë të reja dhe nëse Këshilli e gjykon që ne ta sjellim si projekt edhe për ta bërë, nëse ju jeni dakort dhe e miratoni me atë fond duke qënë kostoja shumë e lartë unë nuk mund ta fus në buxhet për të bërë një investim 600 mijë euro për të ulur koston e energjisë elektrike dhe ngrohjes. Në lidhje me pyetjen për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, rikonstruksioni i pallatit të sportit me qendrën sportive nuk kanë asnjë lidhje me njëra- tjetrën dhe nuk përfitojmë asgjë. Në lidhje me statistikën e përfitimit, duke dashur mos bie ndesh me fjalën e nënkryetarit ka dhe shumë të tjera sepse ne zhvillojmë shumë kampionate, presim ekipe, organizita, aktivitete jo vetëm nga qyteti por edhe nga jashtë dhe janë shumë përfitues mbi 1500 njerëz që marrin të paktën një shërbim por mund të jenë edhe më shumë, por statistikë ekzakte nuk mund të themi sepse janë shumë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Fjala për diskutime.

Këshilltar D.Osmani: Për të vazhduar diskutimin në lidhje me menaxhimin e energjisë elektrike, unë e vlerësoj pjesën që ju keni bërë, duke qënë se ju ju është bërë një ofertë silleni të detajuar për të vendosur Këshilli pro apo kundër sepse duhet parë kostoja e buxhetit. Me një përlogaritje modeste nga ana ime si ekonomist ju me këtë investim duke futur brenda edhe interesat bankare, më shumë se 4 vjet nuk do ju duhet ta shlyheni, nuk e di fuqinë që mendoni ju po deri në 700 Kv mund ta keni të mjaftueshme megjithatë këtë e dinë ekspertët. Duke qënë se qëndra vlerësohet nga të gjithë të majtë apo të djathtë, unë e vlerësoj të duhur për qytetin, ka probleme sit ë gjithë institucionet mundohemi t'i ulim dhe të zhvillojmë sa më shumë aktivitete, por unë mendoj pas 4 vitesh, vitet ikin shpejt ashtu siç ikën këto propozimet tona dhe pas 4 vitesh ajo ngelet e qytetit, e fëmijëve tanë, faleminderit.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Z.Osamni kjo pjesa e energjisë është shumë sensitive në anën ekonomike, jo vetëm e institucionit por edhe qëndrës sportive, kohët e fundit është miratuar një ndryshim në pjesën e matjes të kilovatëve, nëse bëheshin akordimet çdo muaj edhe sa harxhoje sepse konsumi i energjisë nuk është çdo muaj i njëjtë, nëse ti konsumoje x kilovatë këtë muaj dhe pjesa tjetër që do prodhohej ikte "kot", tani bëhet një akordim vjetor nëse harxhojmë x kilovat gjithë vitin ajo pastaj bëhet rakordimi vjetor dhe kjo ishte një ngërç sepse të prodhohej më shumë përshembull për muajt e dimrit dhe në muajt e verës të ikte dhe ne po shohim jo vetëm për qëndrën por edhe për institucionin e Bashkisë, Biblotekës të re të shohim një mënyrë dhe të bëjmë një tabelë të detajuar, me fuqinë, ku do vendosen panelet dhe sa kapacitet mos flasim për një projekt të pa detajuar, shumë e drejtë kjo pjesë.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare nuk besoj se dikush nga ne vë në dyshim funksionin e qëndrës sportive, madje ndihmojmë për të rinjtë e socializuar, dashamirës ndaj sportit, kulturës të disiplinës dhe pikërsiht që është një institucion që të gjithë e përqafojmë duhet të mendojmë në nivel afatgjatë dhe energjia elektrike është apo shpenzimet e energjisë elektrike është ajo thembra e Akilit që duhet të na bëjë të gjithëve krijues. Unë aq sa di sepse punoj në sektorin privat dhe kemi bërë një instalim të tillë, kthimi i investimit është bërë në 3.2 vjet edhe unë e vlerësoj atë që tha Luisi dhe në të njëjtën kohë legjislacioni po shkon drejt asaj që të jetë favorizues si kundër ka edhe mënyra me bateri që ti sot ke diell nesër kohë e vrenjtur ruhet në bateri edhe e shfrytëzon. Për mua është një shumë që duket e madhe në total por duke e parë që ka kthim të investimit edhe dobi duhet parë me syrin e një investimi afatgjatë që ka vlerë dhe do sygjeroja që zyra e projekteve pranë Bashkisë të shikojë mundësinë për aplikime për thirrje Europiane dhe ju duhet të punoni ngushtësisht me ta sepse është në axhendën e BE dhe Komisioni i Evropës herë pas here bën thirrje, ngrin axhenda, ekonomi qarkulluese dhe ne si qytet kemi dëshmuar që jemi taksapagues të rregullt dhe preceptimi është pozitiv ndaj nesh dhe mendoj se do e konsideronin me pozitivitet një aplikim dhe nëse nuk janë mundësi nga jashtë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër kush nuk do donte po të kenë thirrje Bashkitë apo Këshilli i Qarkut janë të parat që aplikojnë me fondet e BE. Ka këshilltarë të tjerë?

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh përgjigjet e marra nga ekzekutivi është e pranueshme shpenzimet do jenë shumë më të mëdha se të ardhurat për shkak se kjo është një shërbim për komunitetin dhe për këtë ne jemi të vetëdijshëm por është e papranueshme siç e thashë edhe më parë faktin se Bashkia është aksionere tek një shoqëri tjetër aksionere, pjesa që i takon kontributit për ekipin e futbollit Skënderbeu duke marrë parasysh edhe faktin që nuk kemi ende një shkresë nga aksioneri mazhoritar që e ka quajtur kryetari i Bashkisë këtu kemi një ngërç për të marrë vendim në lidhje me këtë shumë që ju kalon futbollistëve nëpërmjet kësaj shoqërie. Ajo shumë duhet të qartësohet nëse do kalojë

nëpërmjet kësaj shoqërie apo nëpërmjet ekipit të futbollit Skënderbeu dhe mos konsiderohet si një dhuratë për aksionerin mazhoritar sepse në këtë formë ajo kalon si dhuratë për atë aksioner dhe ky është një shpërdorim i taksave të taksapaguesve Korçarë. Për këtë arsye deklaroj votën time kundër.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qeleshi: Doja të thoja dy fjalë në lidhje me materialin sepse pyetjet teknike i ezauruam në komision. Ky material është tejet i cunguar në shpjegimin e shifrave të shpenzimeve që do buxhetohen në këtë vit që vjen dhe mund të them se nuk kishte një plan analizë shpenzimesh të detajuar për zërat, nuk kishte të dhëna për historikun sepse në historiku bazoheshin shumë të dhëna për shifrat sidomos vlera e konsiderueshme 73. 5 milion që ishin shpenzimet operative që sqaroheshin vetëm me një paragraf, po flas për një qytetar që lexon materialin sepse unë dhe gjithë këshilltarët i ezauruam . Problemi është nëse një qytetar merr lexon këtë tabelën dhe nëse di ta lexojë këtë tabelë por në shpjegimet kur shikon vlerave kaq të konsiderueshme dhe nuk merr sqarime, unë ja bëra dhe punojësve të SHA këtë vërtetë që materiali duhet të jetë shumë i detajuar sepse vlerat janë shumë të konsiderueshme, nuk ka edhe një plan shpenzimesh siç e tha edhe Alketa, çfarë projektesh dhe nuk mund të gjykosh dot nëse planifikimi është bërë brenda rregullave financiare në bazë të materialit sepse nuk mund të vemë në diskutim profesionalizimin e bërë por ne si transparencë nuk e marrim dot këtë informacion.

Këshilltar P.Toklluçi: Të nderuar kolegë ne e kemi diskutuar edhe në komision pjesën e buxhetit të Qendrës kemi disa vite që e diskutojmë, sigurisht e përmendën edhe këshilltarë të tjerë që kjo shoqëri nuk është krijuar për të qënë fitimprurëse por për të ofruar një shërbim, 3-4 zërat kryesore janë bërë transparentë nga punojësit e kësaj shoqërie paga, shpenzime energjie, ngrohje- gaz, paga për personelin. Realisht edhe unë jam dakort për ata që diskutuan parafolësit në lidhje me pjesën e energjisë është në dobi të çdo institucioni drejt energjisë të pastër dhe pa kosto, thjesht është çështja e investimit fillesar e cila është shumë e lartë. Të gjithë do donim të kishim këtë lloj energjie tek çdo institucion, përkrah edhe atë që tha z.Petri për të aplikuar në thirrjet që bën BE, në kushtet që flasim kjo nuk është e mundur, shoqëria dhe Bashkia mund ta shohin në vitet e tjera në vazhdim. Këshu që për gjitha benefitet që ka kjo shoqëri, unë dhe pjesa më e madhe e komisionit jemi dakort me ato shifra që ka sjellë Qeveria, ju ftoj ta miratoni këtë buxhet, faleminderit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 4

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 29 këshilltarë, 25 pro, 4 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kemi një material, një informacion nga qendra në lidhje me inventarizimin e aktiveve afatshkurtra dhe afat gjata dhe në pika të ndryshme kam një kërkesë nga disa këshilltarë në lidhje me problematikën e qenve të rrugës që ne e kemi diskutuar vazhdimisht në mbledhjet e Këshillit. Ka ndonjë gjë nga vetë firmëtarët për ekzekutivin?

Këshilltare A.Zheku: Nga përgjigjia që na është dhënë sepse sot na erdhi, nuk ka asnjë statistikë thuhet vetëm një grup që po i kap, ka evidencuar zonat. Mund të jepet një informacion më analitik sepse kur po flasim për buxhete, për shifra kaq është buxheti në 3 zëra e kategorizuar dhe duhet të ishte një statistike të zonave që janë kapur jo më larg se dhe ka ndodhur një incident tek zona e Pedonales, zona më e nxehtë është Pedonale ku ka turistë dhe zonat e parqeve, unë konstatoj se nuk është bërë evidentimi tek këto zona. Na duhet sa qen janë kapur, janë në ruajtje tek strehëza e katër putroshëve, sa është aktualisht numri i qenve që ndodhet atje?

Kemi dhe zërin ushqim për ta, do të mbahen?

Ideja është të sterilizohen por jo të lëshohen sërish në pedonale sepse edhe një qen i sterilizuar mund të kafoshjë.

Këshilltare M.Qeleshi: Tek Vila Themistokli është bërë një masakër dhe.

Këshilltare A.Zheku: Ju lutem drejtorive përkatëse, nënkryetari është angazhuar.

Këshilltare M.Qeleshi: I kishin thënë në spital je i disati që vjen.

Këshilltare A.Zheku: Ne nuk duam vetëm të sterilizohen por të strehohen atje, të hapen thirrje për birësim pse jo, të bëhen fushata e për të birësuar, kanë shprehur dëshirën e mirë vullnetarë, dashamirës për të kontribuar, qoftë për të dhënë mendime apo edhe specialistë të fushës sepse jo të gjithë mund të bëhemi ekspertë të fushës, rrugët e zgjidhjes janë, falemindarit.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nuk ka nevojë për pyetje sepse informacion është i firmosur nga ju.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare ju thatë nëse keni diçka lidhur me këtë material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Thashë nëse keni komente për të bërë jo pyetje. Fjala për komente nëse doni, thashë kështu sepse mendova të fliste vetëm njëri nga firmëtarët.

Këshilltar L.Petri: Do sygjeroja që kur bëhet kërkesa të paraqitet edhe nga kolegët e tjerë materiali i kërkesës sepse është vënë para kolegëve përgjigjia por nuk është vënë kërkesa. Apo jam gabim Eva?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ja keni drejtuar kryetares të Këshillit dhe kryetarit të Bashkisë.

Këshilltar L.Petri: Tek kjo shkresë që na keni dorëzuar sot bëhet një përmbledhje kronologjike por në thelb po ta shtrydhësh të gjithën është sikur fshihesh me vkb apo vkm në gjethe fiku për të thënë se nuk kemi bërë gjë, faleminderit.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Diçka shkurtimisht në lidhje me kërkesën e këshilltarëve në lidhje me qente endacake, shqetësim që qëndron prej disa kohësh edhe e para informacionin e keni kërkuar në mbledhjen e radhës të Këshillit dhe është sot znj.këshilltare sepse thatë na erdhi sot, sot e keni kërkuar. Unë jam njohur me procedurat që ka bërë ndërmarrja përkatëse me pjesën e fondit siç është pika e parë e kërkesës çfarë është bërë me fondin dhe besoj është shumë e detajuar me zërat përkatëse. Keni kërkuar planin strategjik dhe përsëri ndërmarrja përkatëse ju ka dhënë informacion sesi është procedura deri më sot. Është ngritur një grup pune i përbërë nga punojës të NSHP, policia bashkiake, veterinerë që kemi ne e cila momentalisht po bën kapjen e qenve endacakë në disa zona, kryesisht del në darkë ora

21:30, ka pasur vështirëse sepse në këtë orë nuk gjenden ndoshta duhet të ndryshojnë orar, por për shkak se sigurisë që duhet të ketë pushka pleumatike e cila bën edhe anestezinë e qenit për ta vendosur në gjumë, ky është procesi më i vështirë. Deri tani ne kemi bërë kapjen e 20 qenve endacake në strehëzën e krijuar vetëm për ta dhe që mbahen me ushqim ju mund të shkoni t'i vizitoni, 4 prej tyre kanë erdhur të zotët i kanë marrë përsëri me motivacionin e kemi pasur dhe na ka ikur, kemi verifikuar edhe me këta veterinerët në qytet dhe i falenderoj për dashamirësinë që kanë pasur për të kontribuar. I kanë marrë dhe janë qen të sterilizuar, jemi duke bërë një procedurë për pjesën e sterilizimit sepse ne vërtet nuk kemi kapacitete për ta bërë këtë, qentë vërtet janë atje dhe ushqehen dhe mirëmbahen, ju ftoj të bëni vizitë bashkë me Shoqtat që janë të shqetësuar se ku shkojnë qentë, të na bashkohen, të na ndihmojnë dhe të bëjmë më të mirën për qente endacak edhe të bëjmë thirrje për birësim. Kjo është përmbledhja që kemi bërë deri tani, sapo ka nisur procesi i kapjes, do fillojë dhe procesi i sterilizimit. Ne kemi shumë raste nëpër lagje që ankohen njerëzit për qentë dhe ka e të tjerë që thonë mos na i hiqni qentë sepse i ushqejmë vetë, u alarmuan siç u alarmuan shoqatat sepse mendonin se Bashkia po bën masakër erdhën 4 zonja dhe u cuditën sa mirë i mbanim. Edhe njëherë kush është i interesuar me kontaktet që keni të na bashkoheni në këtë fushatë për qente endacakë dhe të marrë zgjidhje si problem. Në procedurat e prokurimit është një test ku në shqip thuhet test leshmanjoze është test i detyruar, nëse qeni del pozitiv me këtë duhet të eliminohet dhe këtë e bëri një ekspert veteriner. Sipas ligjit qentë të cilët shfaqin agerisivitete ka qen që nuk i kemi ne por vijnë i lëshojnë nga fshatrat, ne pas verifikimit të veterinerit, po bëjmë një kartelë të detajuar për çdo qen në çfarë date kapen, mosha, data e sterilizimit, matrikullimit. Ju ftoj të gjithëve të na bashkoheni sepse procesi i kapjes është shumë i vështirë, vërtet kemi pushkën profesionale që e kemi blerë ka vite, tani kemi marrë materialet agen. Në momentin që gjuhet qeni do 4-5 minuta që anestezia të bëjë efektin dhe ato minuta ne bashkë me punojësit e ndjekim qenin.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Eva ka sjellë relacionin e projekt buxhetit ta merrni edhe të printuar. Do doja të kujtoja diçka ditën e hënë vjen Këshilli i Mallakastrës dhe do doja të jeni, e di që keni angazhimet edhe punët tuaja sepse është ditë e hënë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Mendoj që komisionet t'i lemë ditën e martë dhe këshilltarët të njihen me buxhetin pak më shumë dhe orën e takimit të hënë e caktojmë ne sipas angazhimeve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Do ishte mirë të ishim t'i respektonim sepse ashtu duam edhe ne të na respektojnë kur shkojmë dhe mbledhja e buxhetit do bëhet në datën 26 vetëm nëse data 26 bëhet pushim me vendim qeverie, nuk kemi çfarë bëjmë pastaj.

Këshilltar E.Bregu: Kam parë raste të qenve të kapen nga Bashkia por nuk kam parë të jenë të matrikulluar kur janë lëshuar.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Në material ju kemi thënë që ne kemi bërë kapjen dhe jemi në proces kontaktimi të një veterineri të specializuar i cili do bëjë vaksinimin, sterilizimin dhe matrikullimin. Kemi veteriner por jo të specializuar për sterilizimin.

Këshilltar E.Bregu: Tani që në momentin që janë trajtuar, janë lëshuar.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Nuk kemi lëshuar ne qen.

Këshilltar E.Bregu: Unë di raste që janë marrë dhe janë lëshuar dhe janë pa matrikull.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Nuk ka shanse, ne dy vite rresht kemi bërë procedurë kapje, sterilizim, matrikullimi, para se të kishim qëndrën. Vintë një kompani sipas fondit që miratonim 9 milion lekë të vjetra për 100-150 qen, për këtë fushatë nuk kemi lëshuar.

Këshilltar E.Bregu: Keni lëshuar.

Nënkryetari i Bashkisë K.Kita: Vetëm 4 raste që erdhi i zoti. Një ishte në lagjen 14 (Nuk ka audio.)

Nënkryetare e Këshillit Bashkiak E.Mitre: Akoma nuk është mbyllur nuk kemi thënë mirupafshim.

Shihemi mbledhjen tjetër!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

